



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2024 – Numri: 8

Tiranë – E hënë, 4 mars 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Kërkesë e Ministrisë së Drejtësisë nr. 1251/2, datë 27.2.2024	Për shprehjen e interesit për plotësimin e vendit vakant si noter në Bashkinë Dibër..... 3
Njoftim i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 671, datë 4.3.2024	Për rishpalljen e 1 (një) vendi vakant për pozicionin e Këshilltarit Ligjor në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit..... 3

**URDHËR****Nr. 101, datë 27.2.2024****PËR SHPALLJEN E VENDIT VAKANT SI
NOTER NË BASHKINË DIBËR**

Në mbështetje të neneve 6 dhe 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar; nenit 11 të ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”, i ndryshuar; si dhe urdhrit të ministrit të drejtësisë me nr. 164, datë 10.6.2020, “Për miratimin e rregullave për procedurat e plotësimit të vendeve vakante si noter”,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e vendit vakant si noter në Bashkinë Dibër në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë.

2. Hapjen e procedurës për plotësimin e vendit vakant për noter në Bashkinë Dibër, sipas radhës së plotësimit përcaktuar në ligjin nr. 110/2018, “Për noterinë”, i ndryshuar.

3. Ngarkimin e Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë për marrjen e masave për zbatimin e këtij urdhri.

4. Publikimin e këtij urdhri në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

KËRKESË**Nr. 1251/2, datë 27.2.2024****PËR SHPREHJEN E INTERESIT PËR
PLOTËSIMIN E VENDIT VAKANT SI
NOTER NË BASHKINË DIBËR**

Në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”, i ndryshuar, dhe të urdhrit të ministrit të Drejtësisë me nr. 164 datë 10.6.2020, “Për miratimin e rregullave për procedurat e plotësimit të vendeve vakante si noter”, Ministria e Drejtësisë shpall kërkesën për shprehje të interesit për plotësimin e vendit vakant si noter, në Bashkinë Dibër.

Plotësimi i vendit vakant do të bëhet sipas radhës së mëposhtme:

1. Njëpërmjet transferimit të një noteri që ka kërkuar transferim në këtë pozicion dhe në rast të mosplotësimit të vendit vakant sipas kësaj pike.

2. Njëpërmjet dhënies së licencës së noterit një zëvendësnoteri që ka shprehur interesin për vendin e ri vakant.

Çdo noter i interesuar që kërkon transferimin në këtë pozicion duhet të paraqesë pranë Ministrisë së Drejtësisë brenda 30 ditëve nga publikimi i vendit vakant, dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për shprehjen e interesit për transferimin e veprimtarisë në vendin vakant të shpallur;

2. Kopje të mjetit të identifikimit;

3. Vërtetim mbi vitet dhe vendin e ushtrimit të veprimtarisë si noter;

4. Deklaratë që nuk ka masë disiplinore në fuqi ndaj tij;

5. Vërtetim vendbanimi.

Në rast se vendi vakant nuk plotësohet njëpërmjet transferimit, për shkak të mungesës së kërkesave apo mosplotësimit të kushteve ligjore të noterëve që kanë shprehur interes, plotësohet njëpërmjet dhënies së licencës një zëvendësnoteri, sipas parashikimeve të nenit 13, të ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”, i ndryshuar, dhe urdhrit të ministrit të Drejtësisë me nr. 164, datë 10.6.2020, “Për miratimin e rregullave për procedurat e plotësimit të vendeve vakante si noter”.

NJOFTIM**Nr. 671, datë 4.3.2024****PËR RISHPALLJEN E 1 (NJË) VENDI
VAKANT PËR POZICIONIN E
KËSHILLTARIT LIGJOR NË
KOMISIONIN E PAVARUR TË
KUALIFIKIMIT**

Në zbatim të nenit 22, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit rishpall fillimin e procedurave për personat e interesuar, që kërkojnë të aplikojnë për pozicionin e Këshilltarit Ligjor në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, kategoria e pagës: 80% e G3.

**Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:**

a) Të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë “Master i shkencave” në Shqipëri ose studimet universitare për drejtësi jashtë vendit dhe ka marrë diplomë të njësuar, sipas legjislacionit në fuqi për njësimin e diplomave;

b) Të zotërojë shumë mirë gjuhën angleze;

c) Të ketë shtatë vjet përvojë pune në sistemin e drejtësisë ose në administratën publike.

Kushte të përgjithshme:

- Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret për t’u pajisur me certifikatë sigurie, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015;

- Ndaj tij të mos jetë nisur procedim penal, të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose kundërvajtjeje penale;

- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore me largim nga detyra ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit;

- Kandidatët duhet të kenë aftësi për t’u përshtatur e për të punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

Kandidati i interesuar duhet të dorëzojë dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim, shprehje interesi;

2. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;

3. Kopje të dokumenteve (diplomë, letërnjoftim, librezë pune (origjinale ose të noterizuara));

4. Dëshmi penaliteti;

5. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

6. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe në trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Aplikimet duhet të dorëzohen **brenda datës 13 mars 2024**, pranë institucionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në adresën: Rruga e Kavajës, ish-Lidhja e Shkrimtarëve, Tiranë, zyra e protokollit, nga e hëna–të premte ora 8:30–17:00, ose nëpërmjet postës elektronike në adresën: info@kpk.al, i cili konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit.

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2024

